

MANUAL PËRDORIMI POS



NDEZJA E POS

Mbahet shtypur butoni jeshil.

FIKJA E POS

Mbahet shtypur butoni i verdhë ("< ") dhe butoni pikë (".").

BLERJE NORMALE

POS-i pranon karta Visa dhe Mastercard. Kjo blerje mund të bëhet në dy mënyra:

1 Futet karta me chip

2 Nëpërmjet teknologjisë pa kontakt (Contactless), në ato POS-e të cilët janë të pajisur me një lexues të tillë dhe që kanë shenjën identifikuese.

HAPI 1: Zgjidhet në ekran menuja – BLERJE NORMALE

HAPI 2: Në rast se terminali është në të dyja monedhat (ALL dhe EUR), zgjidhet monedha e kërkuar (ALL ose EUR). Në rast se terminali ka vetëm një monedhë, pas zgjedhjes së "BLERJE NORMALE", kalohet direkt tek shuma për t'u paguar.

HAPI 3: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe kryhet konfirmimi me butonin jeshil.

HAPI 4: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në dy mënyra:

1 Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës

2 Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

HAPI 5: Konfirmohet me butonin jeshil për të vazhduar procedurën

Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Blerja u krye me sukses/Refuzuar" sipas rastit.

HAPI 6: Në ekran shfaqet "Hiqeni kartën".

Kujdes: Nëse karta hiqet përpara se të shfaqet mesazhi "Hiqeni kartën" transaksioni refuzohet. Në rast se transaksioni miratohet, fatura printohet automatikisht në dy kopje dhe blerja konsiderohet e përfunduar.

ANULLIMI I VEPRIMIT

Në POS Credins mund të anulohet vetëm veprimi i fundit.

HAPI 1: Për të kryer anulimin e pagesës së fundit, zgjidhet në ekran menuja – ANULLIM

HAPI 2: Në ekran shfaqet automatikisht veprimi i fundit i kryer në terminal dhe ju duhet të verifikoni katër numrat e fundit të kartës dhe vlerën e faturës të cilën doni të anuloni përpara se të konfirmoni me butonin jeshil anulimin e veprimit.

HAPI 3: Pasi përfundon procedura printohet fatura sërish në dy kopje dhe në këtë mënyrë konfirmohet anulimi i veprimit. Tek Kopja e Tregtarit mbani nënshkrimin e klientit.

RIPRINTIM FATURE

Në POS Credins mund të riprintohet vetëm fatura e fundit.

HAPI 1: Për të bërë riprintim fature në ekran zgjidhet menuja – RIPRINTIM dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 2: Automatikisht riprintohen të dyja kopjet e faturës së fundit.

MBYLLJE DITORE

Mbyllja ditore duhet të realizohet në fundin e çdo dite nëse të paktën keni kryer një transaksion në POS Credins. Ky veprim zeron të gjitha veprimet e kryera atë ditë në POS.

HAPI 1: Për të mbyllur veprimet e një dite dhe për të printuar listen e transaksioneve të kryera në ekran zgjidhet menuja – MBYLLJE DITORE duke konfirmuar me butonin jeshil për të vazhduar.

NDËRRIMI I LETRËS

Për të ndërruar rulonin e letrës, hapet kapaku sipër ekranit dhe vendoset një rulon letre i ri duke lënë pak letër jashtë të kapur nga kapaku i POS.

PARA AUTORIZIM

Veprimi i para-autorizimit përdoret për të mbajtur fillimisht një shumë të caktuar pezull, për ta përfunduar transaksionin në një moment të dytë

HAPI 1: Në ekran zgjidhet menuja – PARA-AUTORIZIM dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 2: Zgjidhet monedha. Në rast se terminali është në të dyja monedhat (ALL dhe EUR), zgjidhet monedha e kërkuar (ALL ose EUR). Në rast se terminali ka vetëm një monedhë, pas zgjedhjes së "PARA-AUTORIZIM", kalohet direkt tek shuma për t'u paguar.

HAPI 3: Vendoset vlera dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 4: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në dy mënyra:

1 - Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës

2 - Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

HAPI 5: Konfirmohet me butonin jeshil për të vazhduar procedurën

Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Para-autorizim u krye/Refuzuar" sipas rastit.

HAPI 6: Në ekran shfaqet "Hiqeni kartën".

Kujdes: Nëse karta hiqet përpara se të shfaqet mesazhi "Hiqeni kartën" transaksioni refuzohet. Në rast se transaksioni miratohet, fatura printohet automatikisht në dy kopje dhe para-autorizimi konsiderohet i përfunduar.

Në rast se kartëmbajtësi nuk është present do të ndiqen hapat e mëposhtëm. Tek Hapi 4: pasi të shfaqet mesazhi "Kaloni Kartën" shtypet dy herë butoni jeshil dhe në ekran do ju shfaqet "Futni PAN".

1 - Vendoset PAN (Numri 16-shifror i kartës) dhe konfirmohet me butonin jeshil

2 - Vendoset Muaji/Viti i vlefshmërisë së kartës

3 - Vendoset CVV – Kodi i sigurisë në pjesën e pasme të kartës dhe konfirmohet me butonin jeshil.

4 - Në ekran shfaqet "A është present kartëmbajtësi?" - Zgjedhim butonin e kuq pasi kartëmbajtësi nuk është present.

5 - Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Para-autorizim u krye/Refuzuar" sipas rastit.

PËRFUNDIM SHITJE

Për të realizuar përfundimin e veprimit "Para-autorizim" ndjekim hapat si më poshtë:

HAPI 1: Në ekran zgjidhni – PËRFUNDIM SHITJE

HAPI 2: Vendoset STAN

HAPI 3: Përzgjidhet monedha ALL ose EUR (në varësi të monedhës në të cilën është prerë fatura) dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 4: Vendoset vlera që i duhet mbajtur klientit dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 5: Vendoset ret. Ref dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 6: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në dy mënyra:

3 - Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës

4 - Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

HAPI 7: Konfirmohet me butonin jeshil për të vazhduar procedurën

Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Përfundim shitje u krye/Refuzuar" sipas rastit.

HAPI 8: Në ekran shfaqet "Hiqeni kartën".

Kujdes: Nëse karta hiqet përpara se të shfaqet mesazhi "Hiqeni kartën" transaksioni refuzohet. Në rast se transaksioni miratohet, fatura printohet automatikisht në dy kopje dhe përfundimi i shitjes konsiderohet i përfunduar.

Në rast se kartembajtësi nuk është present do të ndiqen hapat e mëposhtëm. Tek Hapi 6: pasi të shfaqet mesazhi "Kaloni Karten" shtypet dy herë butoni jeshil dhe në ekran do ju shfaqet "Futni PAN".

1 - Vendoset PAN (Numri 16-shifror i kartës) dhe konfirmohet me butonin jeshil

2 - Vendoset Muaji/Viti i vlefshmërisë së kartës

3 - Vendoset CVV – Kodi i sigurisë në pjesën e pasme të kartës dhe konfirmohet me butonin jeshil.

4 - Në ekran shfaqet "A është prezent kartëmbajtësi?" - Zgjedhim butonin e kuq pasi kartëmbajtësi nuk është prezent.

5 - Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Përfundim shitje u krye/Refuzuar" sipas rastit.

MANUAL ENTRY

Opsioni Manual Entry, Vendosja e të dhënave manualisht, pa praninë fizike të kartës gjatë kryerjes së transaksionit.

HAPI 1: Zgjidhet në ekran menuja – BLERJE NORMALE

HAPI 2: Në rast se terminali është në të dyja monedhat (ALL dhe EUR), zgjidhet monedha e kërkuar (ALL ose EUR).

Në rast se terminali ka vetëm një monedhë, pas zgjedhjes së "BLERJE NORMALE", kalohet direkt tek shuma për t'u paguar.

HAPI 3: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe më pas duhet shtypur butoni jeshil dy herë, për të kaluar në vendosjen manuale të të dhënave të kartës.

HAPI 4: Vendoset PAN (Numri 16-shifror i kartës) dhe konfirmohet me butonin jeshil

HAPI 5: Vendoset Muaji/Viti i vlefshmërisë së kartës

HAPI 6: Vendoset CVV – Kodi i sigurisë në pjesën e pasme të kartës dhe konfirmohet me butonin jeshil.

HAPI 7: Në ekran shfaqet "A është prezent kartëmbajtësi?" - Zgjedhim butonin e kuq pasi kartëmbajtësi nuk është prezent.

HAPI 8: Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Blerja u krye me sukses/Refuzuar" sipas rastit.

BLERJE ME KËSTE

Mundësia e blerjeve me këste është vetëm për kartëmbajtësit të kartave të kreditit Credins.

HAPI 1: Zgjidhet në ekran menuja – BLERJE ME KËSTE

HAPI 2: Në rast se terminali është në të dyja monedhat (ALL dhe EUR), zgjidhet monedha e kërkuar (ALL ose EUR).

Në rast se terminali ka vetëm një monedhë, pas zgjedhjes së "BLERJE ME KËSTE", kalohet direkt tek shuma për t'u paguar.

HAPI 3: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe kryhet konfirmimi me butonin jeshil.

HAPI 4: Futni numrin e kësteve

HAPI 5: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në dy mënyra:

1 - Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës

2 - Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

HAPI 6: Konfirmohet me butonin jeshil për të vazhduar procedurën

Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Duke u lidhur, Duke marrë, Blerja u krye me sukses/Refuzuar" sipas rastit.

HAPI 7: Në ekran shfaqet "Hiqeni kartën".

Kujdes: Nëse karta hiqet përpara se të shfaqet mesazhi "Hiqeni kartën" transaksioni refuzohet. Në rast se transaksioni miratohet, fatura printohet automatikisht në dy kopje dhe blerja konsiderohet e përfunduar.

PËR SUPORT APO PYETJE KONTAKTONI

Orari: 08:30 – 17:00 nga e hëna në të premte

Cel: +355 67 60 56 278 / Cel: +355 67 60 60 960

Orari: 24/7

Kontakti i Call Centerit: +355 4 53 53 000